



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora

---



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU  
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY

**Raporti i grupeve të punës për realizimin e përfundimeve të konferencës kombëtare “Institucionalizimi i mësimit plotësues në diasporë dhe në mërgatë”, e mbajtur nga 21-25 prill 2013 në Durrës**

Takimi i dytë i grupeve të punës për institucionalizimin e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë u mbajt në Durrës, nga 21-25 prill 2013. Në këtë takim, grupet e punës e kanë hartuar kornizën e dokumenteve (secili grup nga fushëveprimtaria e vet), për të cilat do të organizohet debat publik me mësuesit nga diaspora në fund të muajt korrik, kur është paraparë të mbahet edhe Seminari i mësuesve nga diaspora dhe mërgata në Ulqin. **Pas përfundimit të seminarit, një ditë të plotë, grupet e punës do të zhvillojnë debat publik me mësuesit, numri i të cilëve pritet të jetë ndërmjet 123-150. Ndërkaq, para kësaj, grupet e punës do të organizojnë një tubim dyditor të punës në rrethinën e Prishtinës ose të Prizrenit për redaktimin përfundimtar të dokumenteve para diskutimit publik.**

Në punimet e takimit të Durrësit morën pjesë: Shyhrete Gosalci, Ymer Avdiu, Hamdi Bërbatovci (MeD), Nuhi Gashi (MASHT), Rozalba Merdani, Albana Tahiri, Yllka Spahiu, Vjollca Spaho, Elfrida Begaj, Eleni Çoko (MASH), prof.dr. Idriz Vehapi, prof.dr. Ramë Vataj, Lirie Kajtazi (Kuvendi i Republikës së Kosovës), Eset Rama, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Albesiana Ibërhysaj (Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës), prof.dr. Nail Dragaj (Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Mal të Zi), prof.dr. Begzad Baliu (Fakulteti i Edukimit i UP-së) dhe Nuhi Bytyqi (RTK).

Këto ditë, kanë punuar intensivisht katër grupe të punës në seanca plenare dhe të ndara: grupi i rregullativës ligjore, grupi i licencimit të mësuesve, grupi i financimit dhe grupi i sensibilizimit e i informimit. **Grupi i unifikimit të plan-programeve dhe i teksteve mësimore ka punuar vetëm ditën e parë, për shkak se kanë munguar specialistët nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Republikës së Kosovës. Mungesa e specialistëve të MASHT-it, me përjashtim të anëtarit të grupit koordinues, z. Nuhi Gashi, për pjesëmarrësit e takimit është e paqartë, aq më tepër kur të gjithë këta specialistë paraprakisht e kishin konfirmuar pjesëmarrjen. Në çastin e fundit, nga anëtari i grupit koordinues u njoftuam se titullarët e kësaj ministrie kanë marrë vendim që në këtë raund takimesh të marrë pjesë vetëm Nuhi Gashi. Me gjithë shkresën zyrtare të sekretares së MeD-së, znj. Shyhrete Gosalci, dërguar sekretarit të MASHT-i, z. Xhavit Dakaj, për t'i mësuar arsyet e mosmarrjes pjesë të anëtarëve të grupeve punuese nga MASHT-i, kjo mbetet e paqartë. Prandaj, nga të gjithë pjesëtarët e takimit u kërkua që kjo çështje të zgjidhet nga instancat e larta, në të kundërtën e gjithë puna për institucionalizimin e mësimit plotësues në diasporë do të dëmtohet rëndë.**

Grupi i plan-programeve dhe i sensibilizimit e kanë hartuar edhe planin me koston financiare për realizimin e punës së tyre.

Në vazhdim të këtij raporti paraqitet puna e grupeve të punës në takimin e fundit:

## **Grupi profesional i rregullativës ligjore për mësimin plotësues në diasporë dhe mërgatë, i përbërë nga:**

- Mentor Borovci, drejtor i Zyrës Ligjore në MeD, Prishtinë;
- Shyhrete Gosalci, zyrtare ligjore MeD, Prishtinë
- Eset Rama, drejtor i SKQ/ ZKM-së, Prishtinë;
- Albesiana Iberhysaj, drejtor i Zyrës Ligjore MPJ-Prishtinë.
- Drejtori i Zyrës Juridike, MASH, Tiranë;
- Isni Kryeziu, drejtor i Zyrës Ligjore MASHT, Prishtinë;
- Drejtori i Zyrës Juridike MJ e Republikës së Shqipërisë, Tiranë;

*(Pjesëmarrës në takim ish-in: Shyhrete Gosalci, Eset Rama, Rozalba Merdani, Albesiana Iberhysaj).*

### **Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë**

Në mbështetje të neneve 2 dhe 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 19 qershor 2008, si dhe të Protokollit të sesionit të parë të Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar për Bashkëpunimin Kosovë – Shqipëri, i nënshkruar më 15 mars 2013:

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, këtu e më tutje të referuara si palë;

Duke pasur parasysh vlerat dhe interesat e përafërta, si dhe duke i konsideruar nevojat e përbashkëta për organizimin e mësimin për gjuhën dhe kulturën shqiptare në diasporë;

Duke vlerësuar se mërgata shqiptare është një dhe e pandarë;

Duke konsideruar angazhimin dhe interesin e përbashkët për mbështetjen e diasporës dhe mërgatës në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor bien dakord për sa vijon:

#### **Neni 1**

Palët angazhohen që në mënyrë të përbashkët ta organizojnë mësimin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.

## ***Neni 2***

Organizimi i përbashkët i mësimit të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë realizohet në përputhje me legjislacionin e shteteve bashkorganizuese dhe të shtetit në të cilin organizohet mësimi plotësues.

## ***Neni 3***

Organizimi i përbashkët i mësimit të gjuhës dhe të kulturës shqiptare në diasporë ka të bëjë me:

1. Harmonizimin e legjislacioneve përkatëse;
2. Hartimin e kurrikulave dhe të teksteve mësimore të unifikuara;
3. Përcaktimin e standardeve të përbashkëta të rekrutimit të mësuesve;
4. Bashkëfinancimin e projekteve dhe të programeve, të miratuara nga institucionet përgjegjëse të shteteve bashkorganizuese;
5. Organizimin e përbashkët të fushatave sensibilizuese dhe promovimin e aktiviteteve të përbashkëta.

## ***Neni 4***

Mësimi i gjuhës shqipe dhe i trashëgimisë kulturore shqiptare ofrohet për fëmijët shqiptarë në diasporë dhe në mërgatë.

## ***Neni 5***

Palët angazhohen t'i harmonizojnë legjislacionet e tyre përkatëse, me qëllim të organizimit të përbashkët të mësimit të gjuhës dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

## ***Neni 6***

Palët angazhohen për hartimin e kurrikulës së përbashkët, e cila do të zbatohet nga shkollat e mësimit të gjuhës dhe të kulturës shqiptare në diasporë/mërgatë.

Shpenzimet e botimit dhe të shpërndarjes së teksteve mbulohen nga secila palë, në përputhje me numrin e nxënësve pjesëmarrës nga vendet përkatëse.

## Neni 7

1. Mësuesit/mësimdhënësit që do të pranohen, duhet të jenë mësues të diplomuar nga institucionet universitare në profilet përkatëse, si dhe të jenë licencuar sipas bazës ligjore përkatëse nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, si dhe nga ato të Malit të Zi dhe të Maqedonisë.
2. Mësuesit që do të pranohen duhet të jenë mësues të diplomuar dhe të licencuar. Përparësi kanë mësuesit e diplomuar në degët: Gjuhë e letërsi shqipe, parashkollor, cikël i ulët; ndërsa preferohen edhe profilet në degët: histori, gjeografi, etnologji, muzikë dhe arte të hapësirës shqiptare. Këta mësues do të ofrojnë shërbimin arsimor në mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare.

## Neni 8

### Procedura e rekrutimit

1. Pranimi i mësuesve në këto shkolla do të bëhet sipas procedurave dhe kritereve të konkurrimit:
  - a) Paraprakisht identifikohen kushtet dhe masat për shqyrtimin e kërkesave për mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare;
  - b) Kushtet e konkursit të bëhen në përshtatje me specifikat e shtetit ku organizohet mësimi;
  - c) Kriteret për përzgjedhjen e personelit arsimor do të caktohen me Udhëzim Administrativ për mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare. UA nxirret nga ministritë përgjegjëse të arsimit të vendeve të rajonit me interes të përbashkët;
  - d) Kontrata e punës e mësuesve të jetë nga vendi prej nga vjen mësimdhënësi, bazuar në % e numrit të nxënësve;
  - e) Përgjegjësinë për përzgjedhjen e kandidatëve e kanë ministritë e Arsimit, në bashkëpunim me sektorët qeveritarë, përgjegjës për organizimin e diasporës.

2. Për mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare kanë të drejtë të konkurrojnë kandidatë nga Kosova, Shqipëria, si dhe nga trojet e tjera shqiptare, duke pasur parasysh pikën C2.

3. Për mbarëvajtjen e mësimit Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare duhet të caktohet një person përgjegjës, në koordinim me Ambasadat dhe Qendrat Kulturore.

## Neni 9

### Trajtimi financiar dhe shpenzimet operacionale

*Pagesa e mësimdhënësve (ku do të përfshihen ndalesat):*

- *Në rastet kur përbërja e klasës është e përzier me fëmijët nga dy shtetet, pagesa e mësuesit do të bëhet 50 me 50 %. Kjo do të zbatohet vetëm në rastet kur përbërja e nxënësve në klasë të njërit shtet është më tepër se 30 % e numrit të nxënësve në klasë;*
- *Në rastet kur përbërja e nxënësve në klasë nga njëri shtet është mbi 70 % e numrit të përgjithshëm të nxënësve, pagesa e mësuesit bëhet nga ai shtet.*
- *Shpërblim për largësinë e vendbanimit të mësuesit.*

Shpenzimet e organizimit të seminareve për trajnimin dhe kualifikimin e mësimdhënësve që japin mësim në këto shkolla:

- *Shpenzimet e seminareve do të përballohen 50% nga secili shtet përkatës.*

Sigurimi i teksteve mësimore dhe dokumentacioni shkollor:

- *Buxheti i teksteve mësimore të dokumentacionit shkollor përballohet nga shteti përkatës, duke u bazuar në numrin e nxënësve, numrin e klasave dhe numrin e shkollave.*

## Neni 10

Palët bien dakord që, varësisht nga numri i nxënësve që pritet të marrin pjesë në mësimin e gjuhës dhe të kulturës shqipe, të angazhohen për inicimin, përkatësisht për lidhjen e marrëveshjeve me shtetet ku do të bëhet organizimi.

Pas arritjes së marrëveshjes ndërmjet njëres palë dhe shtetit pritës, nxënësit e palës tjetër mund ta ndjekin mësimin e organizuar nga pala nënshkruese e marrëveshjes.

### **Neni 11**

Palët angazhohen për organizimin e përbashkët të fushatave sensibilizuese, promovimin e aktiviteteve të përbashkëta, botimin e revistave të përbashkëta, transmetimin e spoteve promovuese, botimin e broshurave dhe të pllakateve (posterave), organizimin e përbashkët të emisioneve në radio dhe televizion për mësimin plotësues në diasporë, etj.

RTSH-ja dhe RTK-ja marrin pjesë në realizimin e emisioneve të veçanta dhe të fushatave sensibilizuese lidhur me mësimin e gjuhës dhe të kulturës shqipe në diasporë.

Ministria e Diasporës dhe Ministria e Arsimit e mbështesin financimin e këtyre emisioneve.

### **Neni 11**

Palët bien dakord që nga ky organizim i përbashkët të përfitojnë edhe nxënësit e tjerë shqiptarë me prejardhje nga trojet shqiptare.

### **Neni 12**

Për zbatimin e detyrimeve që lindin nga kjo marrëveshje, palët angazhohen t'i krijojnë 5 (pesë) grupe të përbashkëta të punës për arritjen e 5 (pesë) objektivave të përcaktuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.

### **Neni 13**

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi, pasi palët kontraktuese ta kenë njoftuar njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore.

Kjo marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar.

Marrëveshja mund të ndryshohet ose të plotësohet me pëlqim reciprok të shprehur me shkrim nga palët kontraktuese.

Përgatitur në 4 kopje, nga të cilat 2 (dy) në gjuhën shqipe dhe 2 (dy) në gjuhën angleze, të gjitha të barasvlershme ndërmjet tyre.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës  
Shqipërisë

Ministër i Diasporës

Z.Ibrahim Makolli

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së

Ministër i Arsimit dhe i Shkencës

Z. Myqerem Tafaj



## Analizë e konventave dhe e akteve ndërkombëtare ndaj mësimin në gjuhën amtare

1. Deklarata e Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve, e vitit 1924;
2. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut 1948;
3. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 1950;
4. Konventa për të Drejtat Politike e Civile dhe Protokollet Opsionale, 1976;
5. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Diskriminimit në Edukim. neni 5 (1960).

1. **Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 1948,** neni 2 afirmon të drejtën në edukim pa diskriminim;

2. **Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të eliminimit racial, neni 59 (e) (v):**

*Shtetet ftohen jo vetëm të ofrojnë mundësinë e qasjes së barabartë për të gjithë në edukim, por edhe obligohen të ndalojnë/dënojnë dhe të eliminojnë diskriminimin e mundësive në edukim;*

3. **Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore** përcakton:

*Shtetet duhet t'i marrin masat e duhura që t'u mundësojnë pakicave mësimin në gjuhën amtare, përkatësisht neni 4.3 përcakton lejimin e shfrytëzimit të shkollave publike në shtetin pritës;*

*Neni 4.4: shtetet obligohen që sipas nevojës t'i marrin masat në fushën e arsimit, në mënyrë që t'i inkurajojnë njohuritë për historinë, traditat, gjuhën, kulturën e pakicave brenda territorit të tyre;*

4. **Konventa për të drejtat e fëmijëve (1989), neni 18.4:**

*Përcakton që edukimi i fëmijëve duhet të bëhet Inter-Alia për kulturën dhe gjuhën e vendit ku fëmija jeton në raport me vendin e origjinës;*

5. **Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile e politike dhe protokollet opsionale**, po ashtu, proklamon: *shtetet duhet ta respektojnë lirinë e prindërve për të siguruar edukim moral dhe fetar të fëmijëve, në përputhje me bindjet e tyre;*
6. **Konventa për të drejtat e fëmijëve**, përkatësisht neni 29.1(d) kërkon përgatitje në edukimin e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë dhe tolerante në paqe, barazi etj.

# Rezultatet e grupit të punës për kurrikulën e diasporës

1. Nazmi Xhumara MASH (IZHA), Tiranë;
2. Arbër Salihu, MASHT, Prishtinë;
3. Shqipe Z. Gashi, MASHT, Prishtinë;
4. Elfrida Begaj, MASH (IZHA), Tiranë;
5. Gafurr Hyseni, nga Lugina e Preshevës;
6. Yllka Spahiu, Tiranë.

*(Në takim morën pjesë vetëm ditën e parë: Elfrida Begaj, Yllka Spahiu).*

## 1. Hyrje

Në kuadër të projektit për mësimin e nxënësve në diasporë, nga data 18 deri më 20 mars 2013, në Durrës, u mbajt takimi i grupeve profesionale të punës. Në takim u vazhdua puna e bazuar mbi konkluzionet (përfundimet) që kanë dalë nga konferenca kombëtare “Institucionalizimi i mësimin plotësues në diasporë dhe mërgatë/Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, e realizuar në Prishtinë, në dhjetor të vitit 2012.

Në tri ditët e takimit, grupi i punës për hartimin e kurrikulave i shqyrtoi dhe i analizoi konkluzionet e Konferencës. Grupi u përqendrua në hapat konkretë që duhet të realizohen deri në takimin tjetër, që mendohet të mbahet në ndonjë vend evropian, së bashku me mësimdhënësit tanë në diasporë.

## 2. Përfundime

Nga takimi i grupit të punës për unifikimin e kurrikulave të diasporës dolën disa përfundime që janë përcaktuar në pesë pika si vijon:

1. Analiza e konventave ndërkombëtare për arsimin e emigrantëve dhe të fëmijëve të tyre në diasporë t'i kalojë për shqyrtim grupit për legjislacionin, pasi këto konventa kanë më tepër karakter juridik sesa përmbajtësor kurrikular. Grupi i legjislacionit, pas shqyrtimit të konventave, t'i dërgojë një përmbledhje të

shkurtër grupit për unifikimin e kurrikulave lidhur me përmbajtjen e dispozitave të këtyre dokumenteve.

2. Grupi do ta bëjë analizën e kurrikulave për diasporën, të disa vendeve të rajonit dhe të ndonjë vendi tjetër të zhvilluar, për t'i parë përvojat e tyre. Të shikohet edhe përvoja e shkollave shqipe në SHBA (Nju-Jork), si rast më specifik që mund të shërbejë si model.
3. Grupi do t'i analizojë dhe do t'i krahasojë kurrikulat ekzistuese të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës për nxënësit në diasporë, për t'i parë pikëtakimet dhe dallimet.
4. Rezultatet e këtyre analizave do t'u prezantohen mesimdhënësve në takimet që do të mbahen në diasporë, me ç'rast do të diskutohet bashkërisht për nevojat e tyre që duhet të përfshihen në kurrikulën e re.
5. Për përgatitjen e materialeve të mesipërme, grupi i kurrikulave do t'i përcaktojë afatet për përfundimin e tyre para raportit të përgjithshëm përfundimtar të kësaj faze.

### **3. Veprimtaritë konkrete të planifikuara**

Grupi për unifikimin e kurrikulave të diasporës detajoi veprimtaritë konkrete që duhen realizuar si më poshtë:

1. Grupi do ta bëjë analizën e kurrikulave për diasporën, të disa vendeve të rajonit dhe të ndonjë vendi tjetër të zhvilluar, për t'i parë përvojat e tyre. Grupi do ta shqyrtojë edhe përvojën e shkollave shqipe në SHBA (Nju-Jork) si rast më specifik që mund të shërbejë si model.
2. Grupi i përcaktoi (1) treguesit dhe (2) formatin e analizës krahasuese të kurrikulave të diasporës të vendeve të përzgjedhura:

Treguesit/indiktorët (projekt)<sup>1</sup>:

---

<sup>1</sup> Treguesit/indiktorët projekt do të rishikohen për të marrë formën përfundimtare para zbatimit

1. Çfarë formati/struktura ka (synimet, qëllimet, objektivat, përmbajtja, metodologjia, plani mësimor)?
2. Si është e organizuar përmbajtja (me linja, me tema ose me objektiva)?
3. Si është shkalla e integrimit (është e integruar ose me lëndë të ndara)?
4. Si bëhet vlerësimi?
5. Si është plani mësimor (javë në vit, orë në javë, sa është e gjatë ora mësimore) dhe kur e zhvillojnë (gjatë vikendit apo ditët e tjera)?
6. Çfarë metodash mësimore përdorin?

**Formati/matrica e analizës krahasuese (projekt)<sup>2</sup>:**

Treguesit	Shteti				Përfundimet
	Kroacia	Sllovenia	Serbia	Suedia	
Çfarë formati/struktura ka(synimet, qëllimet, objektivat, përmbajtja, metodologjia, plani mësimor)?					
Si është e organizuar përmbajtja (me linja, me tema apo me objektiva)?					
Si është shkalla e integrimit (është e integruar apo me lëndë të ndara)?					

<sup>2</sup> Formatit/matrica do të rishikohet për të marrë formën përfundimtare para zbatimit.

Si bëhet vlerësimi?					
Si është plani mësimor (javë në vit, orë në javë, sa është e gjatë ora mësimore) dhe kur e zhvillojnë (gjatë fundjavës apo ditët e tjera)?					
Çfarë metodash mësimore përdorin?					
Përfundimet					
Sugjerimet					

3. Grupi e përcaktoi hartimin e raportit me gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet nga analiza krahasuese.
4. Grupi e përcaktoi ngritjen e rrejtës së kontaktit mes grupit dhe me mësimdhënësit e specialistët e ndryshëm.
5. Grupi do t'i analizojë dhe do t'i krahasojë kurrikulat ekzistuese të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës për nxënësit në diasporë, për t'i parë pikëtakimet dhe dallimet.
6. Grupi i përcaktoi treguesit e analizës së kurrikulës së shkruar të Shqipërisë dhe të Kosovës për diasporën dhe formatin/matricën e analizës:

Treguesit/indikatorët (projekt)<sup>3</sup>:

1. Çfarë formati/struktura ka (synimet, qëllimet, objektivat, përmbajtja, metodologjia, plani mësimor)?
2. Si është e organizuar përmbajtja (me linja, me tema ose me objektiva)?
3. Si është shkalla e integritit (është e integruar ose me lëndë të ndara)?
4. Si bëhet vlerësimi?
5. Si është plani mësimor (numri i orëve) dhe kur e zhvillojnë (gjatë fundjavës apo ditët e tjera)?
6. Çfarë metodash mësimore përdorin?
7. Dokumentacioni shkollor;
8. Tekste dhe paketa kurrikulare që përdorin.

**Formati/matrica e analizës krahasuese kurrikula e Shqipërisë vs kurrikula e Kosovës (projekt)<sup>4</sup>:**

Treguesit	Shteti		Përfundimet
	Shqipëria	Kosova	
Çfarë formati/struktura ka(synimet, qëllimet, objektivat, përmbajtja, metodologjia, plani mësimor)?			
Si është e organizuar përmbajtja (me linja, me tema apo me			

<sup>3</sup> Treguesit/indikatorët projekt do të rishikohen për të marrë formën përfundimtare para zbatimit.

<sup>4</sup> Formatit/matrica do të rishikohet për të marrë formën përfundimtare përpara zbatimit

objektiva)?					
Si është shkalla e integritimit (është e integruar apo me lëndë të ndara)?					
Si bëhet vlerësimi?					
Si është plani mësimor (javë në vit, orë në javë, sa është e gjatë ora mësimore) dhe kur e zhvillojnë (gjatë vikendit apo ditëve tjera)?					
Çfarë metodash mësimore përdorin?					
Dokumentacioni shkollor					
Tekstet dhe paketa kurrikulare që përdorin					
Përfundimet					
Sugjerimet					

7. Grupi përcaktoi hartimin e raportit me gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet nga analiza krahasuese.



8. Grupi vendosi që rezultatet e këtyre analizave t`u prezantohen mësimdhënësve në takimet që do të mbahen në diasporë, me ç`rast do të diskutohet bashkërisht për nevojat e tyre që duhet të përfshihen në kurrikulën e re.
9. Grupi i përcaktoi takimet me mësimdhënësit në diasporë, të cilat janë parashikuar në përfundimet e konferencës dhe që do të kenë në fokus identifikimin e nevojave dhe interesave të mësuesve dhe nxënësve. Gjithashtu, në takime të ketë mundësisht përfaqësues arsimorë (mësimdhënës, ndonjë zyrtar, specialist), qeveritarë ose komunalë të vendit mikpritës, por edhe prindër të nxënësve.
10. Grupi e përcaktoi strukturën e dimensioneve të instrumenteve që do të përdoren me mësues, nxënës dhe me prindër, për t`i identifikuar nevojat dhe interesat e nxënësve dhe të mësuesve, të cilat do të shërbejnë si bazë për hartimin e kurrikulës së re të unifikuar të diasporës.

### *Dimensionet e pyetësorit të strukturuar me mësues dhe me nxënës (projekt)<sup>5</sup>*

#### I. Kualifikimi

1. Çfarë arsimimi keni (i lartë, i mesëm)?
2. Çfarë dege të studimeve keni mbaruar?
3. Sa kohë keni që jepni mësim (1, 3 ose më shumë vjet)?
4. Sa nxënës keni?
5. Nxënës të cilit nivel keni më shumë (Niveli I: kl.1-3 , Niveli II: 4-6, Niveli III: 7-9, Niveli IV: kl. 10-12)?

---

<sup>5</sup> Dimensionet e pyetësorëve të strukturuar do të rishikohen për të marrë formën përfundimtare para zbatimit.

- II. Plani mësimor (javë, orë në javë, në cilën ditë të javës, mjedisi, sa nxënës ka, cila moshë e nxënësve):
1. Sa javë mësimore është viti juaj shkollor (38 javë, më shumë, më pak)?
  2. Sa orë mësimore keni në javë (1,2 orë, më shumë)?
  3. A e zhvilloni mësimin në fundjavë (po ose jo)?
  4. Në ç`mjedis e zhvilloni mësimin (mjedisi shkollor, mjedis me qira, mjedis shoqate ose tjetër).
- III. Programi :
1. Çfarë program mësimor përdorni (Kosovë, Shqipëri, tjetër- të specifikohet)?
  2. Sa ju ndihmon programi (pak, mesatarisht, shumë)?
  3. Cila pjesë e përmbajtjes së programit është më e asimilueshme/më e përvetësueshme nga nxënësit (gjuha shqipe, historia, trashëgimia/artet, gjeografia)?
- IV. Metodat:
1. Çfarë metoda përdorni më shumë (shpjegimin, projekt, veprimtari praktike, metoda audio-vizuale, ekskursionet)?
  2. A keni marrë trajnime për metodologjitë e mësimdhënies (po, jo)?
  3. A keni organizuar/zhvilluar ekskursionet në vendet e origjinës (po, jo)?
  4. A janë të ngjashme metodat që i përdorni në mësim me metodat që përdoren në shkollat e vendeve pritëse (pak, mesatarisht, shumë)?
- V. Mjetet e mësimdhënies:
1. Çfarë mjetesh përdorni në procesin mësimor (teksti, fletore pune, pllakate (posterë), objekte reale, CD, programe kompjuterike)?
  2. Çfarë tekstesh përdorni (Shqipëri, Kosovë, të tjera)?
  3. A janë të përshtatshme tekstet aktuale (aspak, pak, mesatarisht, shumë)?

- VI. Dokumentacioni shkollor (regjistri/ditari, ditari/plankonspekti, dëshmia, certifikata dhe kush e firmos atë):
1. Ku e pasqyroni vazhdimësinë e procesit mësimor, pjesëmarrjen e nxënësit dhe rezultatet e tyre (në regjistër, portofolio e nxënësit, dokumente të tjera)?
  2. A e pasqyroni përgatitjen tuaj për mësim në ditar/plankonspekt (Po, jo)?
  3. Kujt i raportoni për ecurinë e procesit mësimor dhe për rezultatet e nxënësve (prindërve, përfaqësuesit të ndonjë shoqate, institucioneve përkatëse të vendeve të origjinës, askujt)?
  4. Çfarë dokumenti i lëshoni nxënësit në fund të vitit shkollor (dëftesë, vërtetim, përshkrim ecurie, asgjë)?
  5. Çfarë dokumenti i lëshoni nxënësit në fund të nivelit shkollor (dëftesë, certifikatë, dëshmi, asgjë)?
  6. A ka mbetje (ngelje) të nxënësve në klasë (po, jo)?
- VII. Bashkëpunimi me prindër (a janë prindërit e punësuar, niveli i arsimimit të tyre, a kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në orën mësimore, a e ndihmon prindi nxënësin në detyrat e shtëpisë, a janë të kënaqur fëmijët e tyre nga ky lloj shkollimi, sa ndihmon prindi financiarisht në shkollimin e fëmijës):
1. A bashkëpunoni me prindërit për realizimin e procesit mësimor (pak, mesatarisht, shumë)?
  2. A janë të interesuar prindërit për ecurinë e fëmijëve të tyre në shkollë (aspak, pak, mesatarisht, shumë)?
  3. Me çfarë kontribuojnë prindërit në procesin mësimor (asgjë, mjete mësimore, mjete financiare)?

***Dimensionet e intervistës gjysmë të strukturuar me prindër (projekt)<sup>6</sup>:***

1. Çfarë gjuhe flisni në shtëpi (gjuhën amtare, gjuhën e vendit pritës, të dyjat)?

---

<sup>6</sup> Dimensionet e intervistave gjysmë të strukturuar do të rishikohen për të marrë formën përfundimtare para zbatimit.

2. Sa të nevojshme e quani shkollimin e fëmijës suaj në gjuhën amtare?
3. A vëreni përparim në përdorimin e gjuhës amtare?
4. A ka dëshirë fëmija juaj ta vazhdojë këtë shkollim më tej?
5. Çfarë mendoni se duhet përmirësuar në shkollën e fëmijës suaj?

11. Grupi mendon të zhvillojë pyetësorë të strukturuar me nxënës dhe me mësues, si edhe intervista gjysmë të strukturuar me prindër.

12. Për përgatitjen e materialeve të mësipërme, grupi do t'i përcaktojë afatet për përfundimin e tyre para raportit të përgjithshëm përfundimtar të kësaj faze.

***13. Grupi do të hartojë një plan të detajuar, në të cilin do të përfshihen të gjitha veprimtaritë, afatet kohore, personat përgjegjës, si edhe buxhetimi i tyre.***

# Grupi i unifikimit të kurrikulës së diasporës

PLANI I PUNËS SË VEPRIMTARIVE 2013- 2014

TIRANË, PRISHTINË, 29 MARS 2013

N r	Veprimtaria	Nënveprimtaritë	Afati	Përgjegjësi
1.	Analiza e elementeve të kurrikulave për diasporë të vendeve të rajonit dhe të një ose më shumë vendeve të zhvilluara (Serbi, Maqedoni, Kroaci, Suedi)	1.1 Hartimi i matricës për analizën e kurrikulave të Serbisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe Suedisë	Mars 2013	Nazmi Xhomara <sup>7</sup> Shqipe Gashi Elfrida Begaj Arbër Salihu Gafur Hyseni Nail Draga Yllka Spahiu <sup>8</sup>
		1.2 Sigurimi i kurrikulave të Serbisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe Suedisë. Përshtatja e tyre për analizë.	Prill 2013	“
		1.3 Kryerja e analizës strukturore dhe përmbajtësore e kurrikulave të Serbisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe Suedisë	Maj 2013	“
		1.4 Hartimi i raportit me gjetjet kryesore, përfundimet dhe rekomandimet	Qershor 2013	“

<sup>7</sup> Në një fazë të dytë, pas miratimit të planit të veprimtarive, grupi i kurrikulës do t'i detajojë detyrat/nënveprimtaritë në nëngrupe më të vogla.

<sup>8</sup> Përveç grupit të përhershëm, në të gjitha veprimtaritë dhe nënveprimtaritë e grupit të kurrikulës do të përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në formë elektronike të gjithë mësuesit e diasporës, të cilët do ta ofrojnë ndihmën e tyre me komente, ide, mendime, opinione.

2.	Analiza strukturore dhe përmbajtësore e kurrikulave ekzistues të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për nxënësit në diasporë	2.1 Hartimi i matricës për analizën e kurrikulave ekzistuese të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për nxënësit në diasporë	Mars 2013	Nazmi Xhomara Shqipe Gashi Elfrida Begaj Arbër Salihu Gafur Hyseni Nail Draga Yllka Spahiu
		2.2 Kryerja e analizës strukturore dhe përmbajtësore e kurrikulave ekzistuese të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për nxënësit në diasporë	Maj 2013	“
		2.3 Hartimi i raportit me gjetjet kryesore, përfundimet dhe rekomandimet	Qershor 2013	“
3.	Analiza e mësimdhënies që zhvillohet në diasporë	3.1 Hartimi i treguesve/indikatoreve për t'i identifikuar nevojat dhe interesat e nxënësve, mësuesve dhe prindërve në diasporë	Mars- Prill 2013	Nazmi Xhomara Shqipe Gashi Elfrida Begaj Arbër Salihu Gafur Hyseni Nail Draga Yllka Spahiu
		3.2 Hartimi i instrumenteve studimore për t'i identifikuar nevojat dhe interesat e nxënësve, mësuesve dhe të	Maj- Korrik 2013	“

	<p>prindërve në diasporë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Pyetësor i strukturuar me nxënës</i></li> <li>• <i>Pyetësor i strukturuar me mësues</i></li> <li>• <i>Intervista gjysmë të strukturuar me prindër</i></li> </ul>		
	<p>3.3 Diskutimi me mësuesit e diasporës për dimensionet dhe pohimet e instrumenteve studimore (pilotim në Seminarin Kombëtar të Diasporës)</p>	<p>Korrik 2013</p>	<p>“</p>
	<p>3.4 Vizitë studimore në Gjermani (<i>përqendrimi më i madh i nxënësve në diasporë</i>), me qëllim të identifikimit të nevojave dhe interesave të nxënësve dhe të mësuesve në diasporë. Zhvillimi i instrumenteve studimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Pyetësor i strukturuar me nxënës</i></li> <li>• <i>Pyetësor i strukturuar me mësues</i></li> <li>• <i>Intervista gjysmë të strukturuar me prindër</i></li> <li>•</li> </ul>	<p>Shtator- Tetor 2013</p>	<p>“</p>
	<p>3.5 Vizita studimore në Zvicër (<i>përqendrimi më i madh i nxënësve në diasporë</i>), me qëllim të identifikimit të nevojave dhe interesave të nxënësve dhe të mësuesve në diasporë. Zhvillimi i instrumenteve studimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Pyetësor i strukturuar me nxënës</i></li> <li>• <i>Pyetësor i strukturuar me mësues</i></li> <li>• <i>Intervista gjysmë të</i></li> </ul>	<p>Shtator- Tetor 2013</p>	<p>“</p>

		<i>strukturuara me prindër</i>		
		3.6 Analiza dhe përpunimi i të dhënave të grumbulluara nga zhvillimi i pyetësorëve, si edhe nga takimet e drejtpërdrejta me mësues, nxënës, prindër, si edhe nga vizitat në shkolla dhe në klasa ku zhvillohet mësimi në diasporë	Nëntor-Dhjetor 2013	“
		3.7 Hartimi i raportit studimor me gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet	Janar- Shkurt 2014	“
4	Hartimi i paketës kurrikulare për <i>Gjuhën Shqipe dhe kulturën shqiptare</i> në diasporë	4.1 Hartimi i kornizës kurrikulare (qëllimi, parimet dhe plani mësimor)	Mars - Prill 2014	Nazmi Xhomara Shqipe Gashi Elfrida Begaj
		4.2 Hartimi i kurrikulave (programeve) lëndore <sup>9</sup> <i>1. Gjuhë Shqipe dhe Letërsi</i> <i>2. Histori dhe Gjeografi e Trojeve Shqiptare</i> <i>3. Arte Shqiptare (muzikë, folklor, krijimtari, etnografi...)</i>	Maj- Korrik 2014	Arbër Salihu Gafur Hyseni Nail Draga Yllka Spahiu

<sup>9</sup> Hëpërhë nuk është shkruar ende korniza kurrikulare dhe nuk është kryer analiza krahasuese e kurrikulave të vendeve të marra në shqyrtim, gjë që do të na orientonte se si duhet të jetë e organizuar kurrikula e diasporës (pra edhe programet): me lëndë të veçanta, me lëndë të integruara, me kompetenca apo me tema. **(Mendojmë që në hartimin e kurrikulave të përfshihen edhe 5 ekspertë të nivelit akademik sipas secilës fushë –Shqipja, Arbëri).**



5	Hartimi i dokumentacionit shkollor për <i>Gjuhën Shqipe dhe kulturën shqiptare</i> në Diasporë.	5.1 Hartimi i formës dhe i përmbajtjes së evidencës së realizimit të kurrikulës, vijueshmërisë dhe të dokumenteve certifikuese për nxënësit: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Plani vjetor i mësimdhënies</i></li> <li>2. <i>Regjistri/evidenca e realizimit të kurrikulës dhe e vlerësimit të arritjeve në të nxënë</i></li> <li>3. <i>Dëftesa/certifikata e përfundimit të një viti shkollor dhe të një niveli arsimor (AF, AMU)</i></li> </ol> <p style="color: green;"><i>4.Fletëregjistrimi-plotësohet nga prindërit në fillim të çdo viti shkollor(modelin e disponon G.H) <b>propozimi i Gafurrit</b></i></p>	Prill- Maj 2014	Nazmi Xhomara Shqipe Gashi Elfrida Begaj Arbër Salihu Gafur Hyseni Nail Draga Yllka Spahiu
6	Hartimi i teksteve shkollore të unifikuar për <i>Gjuhën Shqipe dhe kulturën shqiptare</i> në	6.1 Hartimi i setit të treguesve për vlerësimin dhe analizën krahasuese të teksteve shkollore ekzistuese për <i>Gjuhën Shqipe dhe kulturën shqiptare</i> në diasporë, të hartuara në Shqipëri dhe në Kosovë	Mars 2014	Nazmi Xhomara Shqipe Gashi Elfrida Begaj Arbër Salihu Gafur Hyseni Nail Draga Yllka Spahiu
		6.2 Analiza e teksteve shkollore ekzistuese për <i>Gjuhën Shqipe dhe kulturën shqiptare</i> në diasporë, të hartuara në Shqipëri dhe në Kosovë	Prill- Maj 2014	“

Diasporë.	6.3 Hartimi i raportit të vlerësimit të teksteve shkollore ekzistuese për <i>Gjuhën Shqipe dhe kulturën shqiptare</i> në diasporë, të hartuara në Shqipëri dhe në Kosovë	Maj 2014	“
	6.4 Përcaktimi i kriterëve për hartimin e teksteve shkollore për <i>Gjuhën Shqipe dhe kulturën shqiptare</i> në diasporë	Qershor 2014	“
	6.5 Hartimi i teksteve shkollore: <sup>10</sup>  1. <i>Gjuhë Shqipe dhe Letërsi</i> 2. <i>Histori dhe Gjeografi e Trojeve Shqiptare</i> 3. <i>Arte Shqiptare (muzikë, folklor, krijimtari, etnografi...)</i>	Korrik-Dhjetor 2014	“
<b>GJITHSEJ</b>			

<sup>10</sup> Emërtimi i teksteve mund të ndryshojë në varësi të paketës kurrikulare.

## Aneks

### KALENDARI I NËNVEPRIMTARIVE

2013												
Nënveprimtaria	Janar	Shkurt	Mars	Pri ll	Maj	Qers hor	Korr ik	Gus ht	Shtat or	Tet or	Nënt or	Dhje tor
1.1			x									
1.2				X								
1.3					X							
1.4						x						
2.1			x		X	x						
2.2			x		X							
2.3						x						
3.1			x	x								
3.2					X	x	x					
3.3							x					
3.4									x	x		
3.5											x	X
2014												
Nënveprimtaria	Janar	Shkurt	Mars	Pri ll	Maj	Qers hor	Korr ik	Gus ht	Shtat or	Tet or	Nënt or	Dhje tor
3.6	xx	xx	x									
4.1			x	xx	X							
4.2					X	xx	x		x	x		
5.1				x	X							
6.1			x									
6.2				x	X				x	x		
6.3						x						
6.4						x			x			
6.5							x	x	x	xx	xx	Xx

## **C. KUADRI MËSIMOR DHE LICENCIMI I MËSUESVE / MËSIMDHËNËSVE NË DIASPORË PËR MËSIMIN - Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare**

### **Pjesëmarrës të grupit punues në kapitullin C të dokumentit....:**

1. Idriz Vehapi, Kuvendi i Kosovës, Komisioni parlamentar për arsim...,
2. Lirije Kajtazi, Kuvendi i Kosovës, Komisioni parlamentar për arsim...,
3. Albana Tahiri, MASH, Tiranë,
4. Begzat Baliu, Fakulteti i Edukimit, UP
5. Igballe Caka, MASHT, Prishtinë,
6. Ramë Vataj, Kuvendi i Kosovës, Komisioni parlamentar për arsim....
7. Nail Dragaj, Ulqin,
8. Dritan Sallaku, Tiranë.

*(Në takim morën pjesë: Idriz Vehapi, Lirije Kajtazi, Albana Tahiri, Begzat Baliu, Ramë Vataj dhe Nail Dragaj).*

1. Mësuesit/mësimdhënësit që do të pranohen, duhet të jenë mësues të diplomuar nga institucionet universitare në profilet përkatëse, si dhe të jenë licencuar sipas bazës ligjore përkatëse nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, si dhe nga ato të Malit të Zi, dhe të Maqedonisë.
2. Mësuesit që do të pranohen, duhet të jenë mësues të diplomuar dhe të licencuar. Përparësi kanë mësuesit e diplomuar në degët: Gjuhë e letërsi shqipe, parashkollor, cikël i ulët; ndërsa preferohen edhe profilet në degët: Histori, gjeografi, etnologji, muzikë dhe arte të hapësirës shqiptare. Këta mësues do të ofrojnë shërbimin arsimor në mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare.
3. Në vende të ndryshme ku gjuha shqipe është lëndë me zgjedhje e integruar në mësimin e rregullt, mund të pranohet edhe kuadri profesional i specialistëve dhe i kërkuesve shkencorë, të kualifikuar në katedrat e universiteteve dhe të instituteve të Albanologjisë, që përgatiten në vendet përkatëse.

4. Mësuesit, të cilët ofrojnë aktualisht shërbimin arsimor në këto shkolla dhe që janë jashtë profilit të lëndëve që zhvillojnë, që kërkojnë të jenë pjesë e vazhdueshme e mësimit Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare, duhet të kenë kurse trajnimi dhe kualifikimi deri në licencimin e tyre nga vendet përkatëse (si shteti amë, ashtu edhe shteti ku jeton).
5. Përzgjedhja e mësuesve duhet të bëhet me konkurs të hapur; duhen plotësuar kushtet e pikës C.2 dhe të pikës B.1 “Gjuha Shqipe dhe kultura shqiptare”. Gjithashtu, duhet të ketë njohuri elementare të gjuhës dhe të kulturës së vendit ku zhvillohet mësimi Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare.
6. Pranimi i mësuesve në këto shkolla do të bëhet sipas procedurave dhe kritereve të konkurimit:
  - a) Paraprakisht identifikohen kushtet dhe masat për shqyrtimin e kërkesave për mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare;
  - b) Kushtet e konkursit të bëhen në përshtatje me specifikat e shtetit ku organizohet mësimi;
  - c) Kriteret për përzgjedhjen e personelit arsimor do të caktohen me Udhëzim Administrativ për mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare. UA nxirret nga ministritë përgjegjëse për arsim të vendeve të rajonit me interes të përbashkët.
  - d) Kontrata e punës e mësuesve të jetë nga vendi prej nga vjen mësimdhënësi, bazuar në % e numrit të nxënësve;
  - e) Përgjegjësinë për përzgjedhjen e kandidatëve e kanë ministritë e Arsimit, në bashkëpunim me sektorët qeveritarë, përgjegjës për organizimin e diasporës.
7. Për mësimin Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare kanë të drejtë të konkurrojnë kandidatë nga Kosova, Shqipëria, si dhe nga trojet e tjera shqiptare, duke pasur parasysh pikën C-2.
8. Për mbarëvajtjen e mësimit Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare duhet të caktohet një person përgjegjës, në koordinim me Ambasadat dhe Qendrat Kulturore.
9. Mësuesit/mësimdhënësit e mësimit Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare duhet të jenë pjesëmarrës në kualifikime, trajnime/seminare në nivele kombëtare, të organizuara nga bashkëpunimi ndërqeveritar.
10. Kuadri i kualifikuar në vendet e diasporës, sipas profileve të caktuara, të jetë i përfshirë në mësimin Gjuha Shqipe dhe kultura shqiptare.
11. Trajnimi i mësuesve të bëhet sipas programeve lëndore për zbatimin e kurrikulave për diasporën. Risitë didaktike në këto trajnime t’i marrin nga vendet prej nga vijnë mësuesit, pra Kosovë ose Shqipëri, ndërsa trojet e tjera shqiptare do të zgjedhin sipas vendeve më të afërta.

12. Duhet të bëhet krijimi i bazës të të dhënave për mësuesit /mësimdhënësit të përfshirë në mësimin e diasporës.

# FINANCIMI

## Mendimet e grupit të punës në takimin e datës 18, 19 dhe 20.3.2013- Durrës

### Pjesëmarrës:

1. Eleni Çoka
2. Hamdi Bërbatovci

Mendimet sipas konkluzave të dala nga konferenca kombëtare “Institucionalizimi i mësimit plotësues në diasporë dhe në mërgatë”. – Prishtinë, 20 - 23.12.2012

### *1. Hartimi i një rregullative ligjore, në kuadër të ligjeve të aplikueshme me vendet përkatëse, për krijimin e fondeve të mundshme për financimin e mësimin në diasporë.*

1.1. Hartimi dhe harmonizimi i rregullativës ligjore nga Ministria e Diasporës së Kosovës, MASHT-i dhe MASH-i Tiranë, për bashkëpunim në financimin e mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.

1.1.1. Hartimi i kriterëve bazë për financimin sa më të saktë të mësimin plotësues në diasporë, si :

- Numri i shkollave në diasporë sipas vendit përkatës;
- Numri i nxënësve për çdo shkollë sipas grup-moshave dhe largësisë së vendbanimit;
- Numri i mësuesve të angazhuar sipas arsimit përkatës dhe largësës së vendbanimit;
- Mundësitë dhe mënyra aktuale e financimit të mësimin plotësues, si mundësia e financimit të ambientit ku zhvillohet mësimi plotësues, shpërblimi për mësuesit, transporti për nxënësit dhe mësuesit, etj.;
- Hartimi i tabelës për marrjen e indikatorëve të mësipërm.

2. *Krijimi i një linjeje buxhetore, ku do të përfshihen të gjitha shpenzimet për funksionimin e SHSHMP-ve, konkretisht :*
- *Pagesa e mësimdhënësve (ku do të përfshihen ndalesat):*
    - o Mënyra e pagesës së mësimdhënësve do të jetë nga shteti përkatës i fëmijëve pjesëmarrës në atë klasë;
    - o Në rastet kur përbërja e klasës është e përzier me fëmijët nga dy shtetet, pagesa e mësuesit do të bëhet 50 me 50 %. Kjo do të zbatohet vetëm në rastet kur përbërja e nxënësve në klasë të njërit shtet është më tepër se 30 % e numrit të nxënësve në klasë;
    - o Në rastet kur përbërja e nxënësve në klasë nga njeri shtet është mbi 70 % e numrit të përgjithshëm të nxënësve, pagesa e mësuesit bëhet nga ai shtet;
    - o Shpërblim për largësinë e vendbanimit të mësuesit.
  - *Shpenzimet e organizimit të seminareve për trajnimin dhe kualifikimin e mësimdhënësve që japin mësim në këto shkolla:*
    - o Shpenzimet e seminareve do të përballohen 50% nga secili shtet përkatës.
  - *Sigurimi i teksteve mësimore dhe dokumentacioni shkollor.*
    - o Buxheti i teksteve mësimore të dokumentacionit shkollor përballohet nga shteti përkatës, duke u bazuar në numrin e nxënësve, numrin e klasave dhe numrin e shkollave.
3. *Fillimisht, një pilot-projekt i përbashkët për vendet ku mësimi plotësues zhvillohet kryesisht me financimin e prindërore dhe në baza vullnetare. Ky pilot-projekt do të jetë edhe një shprehje e veprimeve konkrete të MASH-it dhe të MASHT-it, si rezultat i kërkesave të herëpashershme të diasporës.*
- 2.1. Pilot-projekti do të vendoset në dy ose tri shtete, në përputhje me kriteret e kësaj pike dhe analizës që do të bëhet me indikatorët e pikës 1.1;
  - 2.2. Pjesë e pilot-projektit do të jetë analizimi i mënyrës së financimit aktual në disa shkolla, ku financimi bëhet nga shteti dhe në disa shkolla ku financimi bëhet nga prindër, donatorë, etj.
4. *Financimi i aktiviteteve të ndryshme (shkollat verore dhe dimërore-kampingje, ekskursionet), me fëmijë të diasporës, ku do të marrë pjesë edhe një numër i kufizuar i fëmijëve të shtetit amë, duke mundësuar që ata të motivohen më tepër, nëpërmjet vizitave në vendin e origjinës dhe nëpërmjet marrëdhënieve të drejtpërdrejta e të natyrshme që vetë fëmijët i vendosin në këto raste me njëri-tjetrin.*
- 4.1. Aktivitetet të parashikohen në plane afatmesme trevjeçare dhe planet vjetore të buxhetit.



4.2. Me plane 3-vjeçare dhe vjetore të parashikohet numri i fëmijëve të diasporës dhe i fëmijëve të shtetit të origjinës që do të marrin pjesë në aktivitet, vendi ku kryhet aktiviteti, si edhe programi i realizimit të aktivitetit.

**5. Donatorëve, të cilët i mbështesin shkollat e mësimit plotësues në diasporë, t'u mundësohet ulja e taksave në sistemin fiskal, në shtetet ku e zhvillojnë aktivitetin e tyre.**

5.1. Të identifikohen donatorët në shtetet përkatëse për mësimin plotësues.

5.2. Të identifikohen shtetet që aplikojnë uljen e taksave për donatorët e mësimit plotësues.

\*Përvoja e financimit të shteteve të tjera për mësimin me fëmijët emigrantë

Evidencimi i numrit të fëmijëve në diasporë- Shteti Gjermania								
Numri rendor	EMRI I SHKOLLËS	Numri i nxënësve gjithsej dhe i grup-moshave				Numri i klasave	Numri i mësuesve	Largësia mesatare në km/mësues *
		Gjithsej	6-9 vjeç	10-12 vjeç	13-16 vjeç			

\* Në llogaritjen e largësisë mesatare fillohet nga 15 km e lart. Në fund të tabelës të evidencohet numri i mësuesve sipas shkollave dhe km faktike për secilin mësues.

## **Rezultatet e grupit të punës për sensibilizim dhe mediatizim të mësimit plotësues në diasporë**

Në takimin e mbajtur në Durrës, më 18,19 dhe 20 mars dhe në takimin më 22, 23, 24 e 25 prill 2013, grupi i punës për sensibilizim dhe mediatizim të mësimit plotësues në diasporë ( i përbërë nga Besa Bytyqi – MASHT dhe Vjollca Spaho – MASH, si dhe Nuhi Bytyci, nga RTK) ka hartuar një plan të aktiviteteve për periudhën njëvjeçare.

Aktivitetet e parapara:

### **Spotet promovuese:**

Janë planifikuar të përgatiten tri spote promovuese:

1. Spoti i parë të jetë përgjithësues dhe i fokusuar në ruajtjen e gjuhës shqipe, si mjet i mbajtjes së lidhjes me atdheun, traditën shqiptare dhe vlerësimin e gjuhës shqipe si mjet komunikimi, mjet avancimi ekonomik, shoqëror global në mbarë Evropën dhe botën.
  - Spoti të ketë në qendër fëmijë të suksesshëm shqiptarë që jetojnë në vende të ndryshme, por që gjuha shqipe i ka ndihmuar në suksesin e tyre (pra duhet të theksohet rëndësia që ka gjuha amtare në sukseset e tyre kudo që jetojnë).
  - Ekspertë të arsimit, psikologë e sociologë që theksojnë shkurtimisht rëndësinë që ka ruajtja e gjuhës dhe e kulturës kudo që jetojnë këta fëmijë.
2. Spoti i dytë të realizohet me personalitete të institucioneve të Kosovës dhe të Shqipërisë – ministrat e Arsimit Ramë Buja, Myqerem Tafaj dhe ministri i Diasporës, Ibrahim Makolli.
  - Spoti të ketë si përmbajtje thirrjen institucionale, por të bëjë të ditur edhe kujdesin që ofrojnë vendet e origjinës për mësimin plotësues në diasporë.
3. Spoti i tretë të jetë i realizuar me personalitete të rëndësishme (me ndikim), vendëse dhe ndërkombëtare (Rita Ora, Gjerdan Shaqiri, Inva Mula, Luan Krasniqi...)
  - Spoti të jetë një këngë promovuese e gjuhës, e kulturës dhe e traditës shqiptare, e kënduar nga personazhe të ndryshme të rëndësishme dhe me ndikim).

Audienca: Spotet do të transmetohen në televizionet dhe në radiot publike (sidomos në programin satelitor), në uebportalet zyrtare të ministrive përkatëse, portalet e ndryshme.

Afati kohor: Koha e realizimit të spoteve të jetë qershor – korrik.

## **Emisionet debatuese**

Për të theksuar rëndësinë e mësimit plotësues në diasporë, respektivisht ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe të traditës shqiptare, do të organizohen 3 debate (çdo katër muaj) çdo muaj në televizionet dhe në radiot kombëtare.

## **Emisionet e ndryshme (dokumentaret, reportazhet) edukativo-arsimore dhe kulturore**

Emisionet duhet të jenë pjesë e skemës programore të televizionit publik të Kosovës dhe Shqipërisë, me theks të veçantë për ciklet e ulëta të shkollave. Emisionet, reportazhet do të pasqyronin kulturën shqiptare, si edhe jetën e komunitetit shqiptar në vende të ndryshme, rëndësinë e mësimit plotësues, metodologjitë e punës, etj.

1. Dokumentari i parë: Përgatitja e një dokumentari nga jeta e shqiptarëve në vendet ku organizohet mësimi plotësues në diasporë dhe nga vendet ku mungon ky mësım. Të theksohet rëndësia e mësimit plotësues. Dokumentari të shfaqet në televizionet publike, por të publikohet edhe në faqet zyrtare të tri ministrive.
2. Dokumentari i dytë: të ketë përmbajtje ekskluzivisht për fëmijët, me ç' rast ata do t'i marrin njohuritë themelore për gjuhën, traditën dhe kulturën shqiptare. Po ashtu, ky dokumentar transmetohet nga televizionet publike dhe publikohet në faqet zyrtare të ministrive përkatëse (Përgatiten edhe një numër i DVD-ive, të cilat **shpërndahen** falas në diasporë nëpërmjet ambasadave dhe formave të tjera).

## **Broshurat dhe pllakatet (posterët)**

Grupi duhet të përgatitë broshura dhe pllakate, ku do të theksoheshin nevoja dhe rëndësia e mësimit plotësues në gjuhën amtare, si dhe do t'u bëhej ftesë prindërve, mësımndhënësve dhe nxënësve që të informohen për hapat konkretë që duhet të ndiqen.

Grupet në shënjestër: Prindërit, mësımndhënësit dhe nxënësit;

Qëllimi: Informimi dhe sensibilizimi;

Motoja: "Mësimi plotësues në diasporë dhe në mërgatë obligim dhe qëllim kombëtar".

1. Përgatitja e një broshure me fotografi dhe informacione për vendet që e zhvillojnë mësımın plotësues në gjuhën shqipe (për mësımndhënës dhe prindër);

2. Përgatitja e një periodiku prej 4 faqesh (i cili do të botohet çdo 3 muaj) për fëmijët e diasporës.

Shpërndarja: Materiali do të shpërndahej në shtetet ku është e koncentruar diaspora, varësisht nga mundësitë logjistike.

Këto broshura do të shpërndahejshin në çdo aktivitet, organizim, konferencë të ministrive përkatëse jashtë vendit.

Një sasi e caktuar e broshurave do t'u dërgohej ambasadave dhe zyrave për marrëdhënie me jashtë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, në mënyrë që të krijohen sa më shumë pika informuese për pjesëtarët e diasporës.

Një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e broshurave do të mund të luanin aktorët e terrenit, si LAPSH, SHBSH dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile që mund të bëjnë shpërndarjen në shkollat shqipe në diasporë, në lokale ku mbledhen shqiptarët, por edhe bizneseve të suksesshme afariste shqiptare në diasporë, të cilat do t'i mbanin këto broshura në lokalet e tyre, etj...

### **Komunikatat, njoftimet dhe konferencat për media**

Ministria e Arsimit të Shqipërisë dhe ajo e Kosovës, si dhe Ministria e Diasporës do t'i realizojnë dy (2) konferenca. Konferencat të jenë të përbashkëta nga tre ministrat: Tafaj, Buja e Makolli.

1. Konferenca e parë: prezantohen hapat e ndërmarrë për institucionalizimin e mësimin plotësues në diasporë;
2. Konferenca e dytë: prezantimi i të arriturave për një kohë të caktuar;
3. Zyrat e komunikimit të tri ministrive: Ministria e Arsimit të Shqipërisë dhe ajo e Kosovës dhe Ministria e Diasporës do ta njoftojnë vazhdimisht opinionin publik për të arriturat, nëpërmjet komunikatave, njoftimeve...

### **Gazetat/ revistat zyrtare**

Duke qenë se të dy ministrinë e arsimit i nxjerrin revistat arsimore (Revista "Mësuesi" – MASH, revista "Mësuesi i Kosovës" – MASHT dhe revista me aktivitetet e MeD-së), të

shfrytëzohen që çdo numër të kenë edhe shkrime për mësimin plotësues në diasporë. Por, të inkurajohen edhe revistat zyrtare të institucioneve të tjera që të kenë shkrime nga dhe për diasporën për sektorë të ndryshëm që mbulojnë.

Hapja e një portali të përbashkët didaktik me bashkëfinancim të institucioneve të Kosovës dhe Shqipërisë.

### **Themelimi i çmimeve**

Të tri ministrinë do ta shpallin Muajin e Diasporës, i cili duhet të jetë muaji qershor. Gjatë këtij muaji, të realizohen aktivitete të ndryshme, të cilat u përmendën më lart. Po ashtu, të themelohen edhe dy çmime:

1. Çmimi i parë: të zgjidhet storja/shkrimi më i mirë në medie për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditës shqiptare (çmimi për TV, radio dhe gazetë). Kjo do t'i nxitë mediet që për një muaj të shkruajnë rreth diasporës. Çmimi i parë të jetë 500 € për të tria llojet e gazetarisë, çmimi i dytë 350 € dhe çmimi i tretë 200 €. Shkrimet konkurruese i vlerëson një komision i përbërë nga 3 ministrinë.
2. Çmimi i dytë: gjatë muajit të diasporës të shpallet konkursi për esenë më të mirë lidhur me gjuhën, kulturën dhe traditën shqiptare. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë vetëm fëmijët nga diaspora. Eseja vlerësohet nga një komision i përbërë nga 3 ministrinë dhe çmimi të jetë 500 €.

### **Krijimi i portalit informues**

Të tri ministrinë të obligohen që të krijojnë një portal informativ për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë, i cili do të përmbajë të gjitha informatat e nevojshme, materiale mësimore, tekste mësimore etj.

### **Shfrytëzimi i medias sociale**

Të shfrytëzohen mediet sociale (facebook dhe twitter) për fushatën lidhur me rëndësinë e mësimin plotësues në diasporë.

Të shfrytëzohen bashkësitë fetare që të krijojnë mundësitë që ritualet fetare të bëhen në gjuhën shqipe dhe nga predikuesit (priftërinjtë e imamët shqiptarë).

Të organizohen takime me bashkatdhetarë gjatë pushimeve verore dhe dimërore, por edhe në vendet ku jetojnë për rëndësinë e shkollimit në gjuhën shqipe.

Të organizohen tubime me gratë e diasporës për përfshirjen e fëmijëve në shkollimin plotësues në gjuhën shqipe.

**Vërejte: Koordinatorët e grupeve të punës obligohen që këto materiale t'ua dërgojnë anëtarëve të grupeve të punës nga diaspora dhe të komunikojnë me ta "online". Vërejtjet e tyre eventuale të inkorporohen në tekste para diskutimit publik.**

Durrës, më 25. 4. 2013